



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 909/Prot.  
11

Tiranë, më 23.06 2021

V E N D I M

Nr. 33, datë 23.06.2021

**“PËR  
MIRATIMIN E PAGESAVE TË ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME, ANËTARËVE TË NJSBC DHE NDRYSHIM  
PAGESË TË SEKRETARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT”**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në IAL e RSH”, në nenin 43, pika “rr”, të Statutit të UST-së, në nenin 10, pika 7, të Rregullores së UST-së, në Vendimin e Senatit Akademik nr.81 datë 07/05/2021 “Për ngritjen e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore”, në Vendimin e Senatit Akademik nr.82 datë 07/05/2021 “Ngritjen e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët”, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 86 datë 14/05/2021 “Për ngritjen e Komisionit të Kurrikulave”, Vendimin Qarkullues Senati nr. 93 datë 19.05.2021 “Për riorganizimin e njësisë së brendshme të cilësisë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, , në Vendimin e Senatit nr. 97 datë 07.06.2021 “Për miratimin e propozimit për pagesat e anëtarëve dhe sekretareve të komisioneve të përherëshme, anëtarëve të NJSBC dhe ndryshim pagese të sekretarit të bordit të administrimit”, Bordi i Administrimit i UST-së, në mbledhjen e tij të datës 23/06/2021,

**V E N D O S I:**

1. Të mirarohet pagesat e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Përherëshme, anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ndryshim të pagesës së Sekretarit të Bordit të Administrimit, si më poshtë vijon :
  - a- Anëtarët e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë,  
Botimeve dhe Projekteve Shkencore 25 000 lek / në muaj, për 10 muaj  
Sekretari i Komisionit 12 000 lek / në muaj, për 10 muaj

- b- Anëtarët e Komisionit të Kurrikulave 20 000 lek / në muaj, për 5 muaj  
Sekretari i Komisionit 12 000 lek / në muaj, për 5 muaj
- c- Anëtarët e Komisionit të Mbarëvatjes së  
Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët 15 000 lekë / në muaj, për 10 muaj  
Sekretari i Komisionit  
(do të mbulohet nga një prej anëtarëve dhe do të marri + 5 000 lek / në muaj)
- d- Anëtarët e Njesisë të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë  
10 000 lek / në muaj, për 9 muaj
- e- Ndryshim të pagesës së Sekretarit të Bordit të Administrimit  
nga 10 000 lek në muaj në 15 000 lek në muaj
- 2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
- 3.Efektet financiare fillojnë nga 01.06.2021.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**HYSEN DOMI**

